



USAID Kosovo Investment Promotion and Access to Finance Activity

Fondi i Granteve

Deklarata Vjetore e Programit #I

Nr.: APS-2024-001

- Lëshuar nga:** USAID Kosovo Investment Promotion and Access to Finance Activity.
- Data e lëshimit:** 8 mars 2024.
- Data e mbylljes:** 30 shtator 2024, ora 15:00 CET.
Aplikimet e hershme inkurajohen fuqimisht.
- Lënda:** Ftesë për subjektet e kualifikuara për të paraqitur Shprehjet e Interesit për financim të partneritetit për tërheqjen e mundësive të investimeve dhe zgjerimin e disponueshmërisë së qasjes në financa në Kosovë.
- Qëllimi:** Marrja e propozimeve nga organizatat e kualifikuara përmes Shprehjeve të Interesit për forcimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme përmes tërheqjes së investimeve dhe rritjes së qasjes në financa.
- Përshtatshmëria:** Organizatat e kualifikuara përfshijnë organizatat e regjistruara ligjërisht në Kosovë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Organizatat e vendeve të treta mund të konsiderohen në baza individuale. Organizatat e përshtatshme për kualifikim mund të jenë organizata jo-fitimprurëse, fitimprurëse dhe organizata joqeveritare.
- Financimi:** Fondet e dhëna do të jenë nga EUR 30,000 deri në EUR 230,000 (ose ekuivalent me vlerën USD 250,000). Fondet nën EUR 30,000 mund të jepen në rrethana të veçanta dhe të arsyetuara mirë.
- Informacioni:** Informacion shtesë mbi Fondin e Granteve mund të gjendet në www.portalpune.com dhe www.kosovajob.com, si dhe në Rrjetin e Investimeve dhe Financave të Kosovës në <https://www.facebook.com/KosovoInvestemandFinanceNetwork>
- Aplikimi:** Aplikantët mund të dorëzojnë aplikacionet tek grants.ipaf@dt-global.com.

I. Historiku i Projektit

USAID Kosovo Investment Promotion and Access to Finance Activity (në tekstin e mëtejshëm “Aktiviteti”) financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Aktiviteti implementohet nga DT Global si kontraktor kryesor, së bashku me Recura Financials me bazë në Kosovë dhe Connexus Corporation me bazë në SHBA, si nënkontraktorë.

Aktiviteti është një projekt pesëvjeçar që synon të forcojë kapacitetin e sektorit privat për të ofruar rritje ekonomike të qëndrueshme përmes dy objektivave që përforcojnë njëri-tjetrin:

- Objektivi 1: Tërheqja e investimeve.
- Objektivi 2: Rritja e qasjes dhe shfrytëzimit të financave të diversifikuara.

Aktiviteti adreson një nga kufizimet kryesore për rritjen e sektorit privat, pra mungesën e qasjes në forma alternative të investimeve dhe financimit. Rritja e burimeve të investimeve dhe financave do t'i mundësojë sektorit privat të zgjerohet, të krijojë vende pune produktive, të rrisë eksportet dhe të miratojë teknologji dhe praktika të reja afariste. Duke vepruar kështu, Aktiviteti kontribuon në qëllimin e përgjithshëm të USAID-it për rritjen e mundësive për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse ekonomike.

2. Fushat Kryesore të Përqëndrimit

Aktiviteti do të përqëndrohet në fushat në vijim:

- Forcimin e kapaciteteve të Qeverisë së Kosovës për të tërhequr investime duke mbështetur Agjencinë për Promovimin e Investimeve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe duke ndihmuar në zhvillimin e një kornize ligjore që mbështet tërheqjen e investimeve.
- Partneritetin me subjektet e sektorit privat për tërheqjen e investimeve dhe ngritjen e fondeve të investimeve në Kosovë.
- Rritjen e shumëllojshmërisë së produkteve financiare për bizneset dhe investitorët në Kosovë duke punuar me institucionet financiare për të prezantuar produkte të reja.
- Zhvillimin e kornizës ligjore dhe rregullatore për vënien në funksion të tregjeve të kapitalit në Kosovë.
- Mbështetjen e rritjes së produkteve alternative të financimit dhe mbështetjen e bizneseve të sektorit privat rreth gatishmërisë për të investuar.

3. Qëllimi i Financimit

Përmes kësaj mundësie për financim, Aktiviteti fton aplikantët potencialë të kualifikuar të paraqesin propozime për ide dhe zgjidhje konkrete për financim, që synojnë të tërheqin investime në mënyrë të qëndrueshme dhe të rrisin disponueshmërinë e produkteve të shumëllojshme të financimit.

Aktiviteti ofron këtë mundësi për financim për të identifikuar partnerë të aftë që kanë njohuri dhe kapacitet për të identifikuar problemet dhe propozuar zgjidhje që funksionojnë për të arritur dy qëllimet kryesore të Aktivitetit.

Aktiviteti inkurajon aplikantët e interesuar për të siguruar financim përmes këtij instrumenti financimi që ta shohin këtë mundësi më shumë se sa thjesht marrjen e një granti. Qëllimi i financimit është të

nxisë partneritetet mes Aktivitetit dhe subjekteve të afta në një aleancë për të punuar bashkë në drejtim të arritjes së qëllimeve të lartshënuara të Aktivitetit.

Aktiviteti do të përdorë metoda lehtësuese, të bazuara në treg për të ofruar grantet në mënyrë strategjike për të zvogëluar rrezikun, për të demonstruar ndikimin, për të stimuluar inovacionin dhe për të rritur aktivitetet gjithëpërfshirëse në të dy objektivat e Aktivitetit dhe synon të përdorë kryesisht *grante me pagesë për performancën*.

4. Qasja Sistemike

Aktiviteti do të mbështesë dhe fuqizojë kryesisht organizatat dhe subjektet lokale për të dalë me ide inovative në promovimin e investimeve dhe produkteve dhe shërbimeve të shumëllojshme financiare. Fondi i granteve do të synojë të mbështesë nismat ose zgjidhjet që mund të vazhdojnë pa ndihmën e donatorëve. Propozimet e suksesshme nga aplikantët duhet të japin një argument të qartë dhe të besueshëm në lidhje me natyrën e ndikimit sistematik që aplikuesi pret të rezultojë nga partneriteti me Aktivitetin.

5. Kufizimet kryesore

Aktiviteti ka kryer [Analizën e Kufizimeve të Financave dhe Investimeve \(AKFI\)](#) për të vlerësuar kufizimet kryesore që pengojnë tërheqjen e investimeve dhe qasjen në financa në Kosovë. Disa nga kufizimet kryesore të identifikuara në AKFI përfshijnë:

Objektivi 1: Tërheqja e investimeve

- **Kapaciteti i dobët i qeverisë.** Kapacitetet aktuale të promovimit të investimeve të qeverisë perceptohen gjerësisht si të kufizuara. Qeverisë së Kosovës (QK) aktualisht i mungon një strategji gjithëpërfshirëse dhe e koordinuar për promovimin dhe tërheqjen e investimeve. Koordinimi i dobët ndërmjet institucioneve të QK-së që janë përgjegjëse për angazhimin me investitorët dhe tërheqjen e investimeve pengon investimet. Kapaciteti i dobët institucional poashtu pengon institucionet e QK-së në zhvillimin dhe zbatimin e politikave për të tërhequr në mënyrë efektive investimet.
- **Mjedisi i biznesit.** Mjedisi i biznesit në Kosovë pengon investimet në shumë mënyra. Investitorët që kërkojnë të operojnë në Kosovë duhet të marrin shumë licenca dhe leje nga shumë subjekte të QK-së. Nuk ka asnjë subjekt të vetëm dhe efektiv që shërben si pikë e vetme shërbimi për investitorët. Në të njëjtën kohë, proceset e falimentimit në Kosovë janë joefikase dhe të pashfrytëzuara nga bizneset dhe zgjidhja e kontesteve kontraktuale përmes sistemit gjyqësor është shumë e ngadaltë. Ndërkohë, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës kanë kapacitet të kufizuara teknik për t'i shërbyer efektivisht investitorëve dhe për të rregulluar aktivitetin e tregut.
- **Mungesa e indeksit të borxhit sovran.** Ndryshe nga shumica e vendeve të saj fqinje, Kosova nuk ka indeks të borxhit sovran. Për disa investitorë të huaj potencialë, mungesa e indeksit të borxhit sovran i pengon investimet duke përforcuar perceptimet e tyre para-ekzistuese për Kosovën si një vend i paqëndrueshëm dhe me rrezik të lartë.

Objektivi 2: Financat e diversifikuara:

- **Konkurrenca e kufizuar.** Sistemi financiar i Kosovës dominohet nga bankat komerciale, të cilat përballen me pak konkurrencë dhe janë shumë fitimprurëse. Si pasojë, bankat kanë

pak nxitje për të synuar rritjen tutje të qasjes në financa për NVM-të ose për të zhvilluar instrumente financiare të diversifikuara. Bankat e Kosovës janë shumë të kujdesshme ndaj rrezikut dhe vendosin kërkesa të larta dhe të rrepta për kolateral pothuajse për të gjitha kreditë.

- **Kërkesat për kolateral.** Shumë biznese nuk mund të marrin kredi bankare sepse nuk janë në gjendje ose nuk janë të gatshme të lënë garanci asete të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e kolateralit të një banke.
- **Opsionet e kufizuara të financimit.** Pak biznese janë në gjendje të marrin financim për projekte ose kredi të sindikuara nga bankat. Opsionet e financimit për NVM-të jashtë kredive standarde bankare janë shumë të kufizuara. Instrumentet financiare alternative, si faktoringu dhe lizingu, nuk ofrohen gjerësisht nga bankat apo institucionet financiare jobankare. Ka një disponueshmëri dhe përdorim shumë të kufizuar të mbledhjes dhe tregtimit të fondeve (crowdfunding) ose produkteve të tjera të teknologjisë financiare (fintech).
- **Tregjet e kapitalit dhe fondet e investimeve.** Përveç obligacioneve qeveritare, nuk ka tregje aktive të kapitalit në Kosovë. Bizneset lokale nuk lëshojnë letra me vlerë borxhi ose ekuiteti dhe nuk ka shkëmbime apo platforma për të tregtuar këto letra. Nuk ka as fonde të investimeve me bazë në Kosovë që ua mundëson investitorëve të bashkojnë kapitalin e tyre, të diversifikojnë rrezikun e tyre dhe të investojnë në mënyrë indirekte në një numër biznesesh vendore. Zhvillimi i tregjeve të kapitalit pengohet nga faktorë të shumtë, duke përfshirë përmasat e vogla të ekonomisë së Kosovës, mungesën e një kornize ligjore dhe rregullatore, dhe mandatet e kufizuara të investimeve të fondeve të pensioneve dhe kompanive të sigurimit të Kosovës. Kapaciteti i kufizuar dhe informaliteti i NVM-ve është gjithashtu një faktor i rëndësishëm që kufizon qasjen në financa.
- **Sfidat me të cilat përballët sektori privat.** Qeverisja e dobët korporative, raportimi i pasaktë i financimit dhe planifikimi i dobët i biznesit i pengojnë bankat dhe investitorët të ofrojnë kapital për NVM-të. Kosova nuk ka një rrjet të gjallë/aktiv të ofruesve të shërbimeve këshilluese të biznesit për të forcuar kapacitetin e firmave në kryerjen e transaksioneve financiare me ofruesit e kapitalit.

Aplikantët sipas kësaj mundësie të financimit duhet të demonstrojnë në mënyrë të qartë se si propozimet e tyre për financim kërkojnë të adresojnë të paktën një kufizim të identifikuar (i cili nuk kufizohet vetëm tek shembujt e përmendur më lart).

6. Rezultatet Kryesore të Dëshirueshme

Aplikacionet e paraqitura sipas kësaj thirrje kërkojnë të dëshmojnë se si kërkesat e tyre për financim dhe aktivitetet e propozuara kontribuojnë në të paktën një nga treguesit e mëposhtëm. Ndonëse kërkesat vlerësohen nga këndvështrime të shumta, ato që tregojnë qartë potencialin më të madh për ndikim në një ose mundësisht më shumë tregues të rezultateve më poshtë (ose të gjithë) do të kenë gjasa më të mëdha për miratimin e financimit të kërkuar.

- Rritja e vlerës së investimit të ri.
- Rritja e numrit të investitorëve të rinj të interesuar.
- Rritja e vlerës së financimit të ri.
- Rritja e numrit të partneriteteve të reja publike/private që çojnë në rritjen e investimeve private.
- Rritja e numrit të llojeve të reja të financimit të prezantuara dhe të shfrytëzuara.
- Rritja e numrit të ndërmarrjeve të sektorit privat me qasje të shtuar në financa.

- Rritja e numrit të stafit të institucioneve financiare të trajnuar për financa të diversifikuara.
- Rritja e numrit të lidhjeve të reja ndërmjet biznesit kosovar dhe investitorëve të huaj.
- Përmirësimi i sistemit rregullativ dhe ligjor si në investime ashtu edhe në financa.

7. Fushat Prioritare për Financim

Përmes kësaj thirrjeje për financim, Aktiviteti mirëpret çdo aplikacion me ndikim dhe inovativ që mbështet objektivat e lartcekura, gjeneron ndryshime sistemike dhe kontribuon dukshëm në treguesit e listuar më sipër.

Objektivi I – Tërheqja e investimeve

Prioritetet kryesore të financimit përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Promovimi dhe tërheqja e investimeve:
 - Inicativat dhe ngjarjet që synojnë rritjen e **ndërgjegjësimit** dhe zgjerimin e **informacionit të tregut** për mundësitë e investimit në Kosovë, **duke promovuar dhe lehtësuar** investimet e huaja në Kosovë, dhe **duke i lidhur** sipërmarrësit kosovarë me investitorë të huaj.
 - Inicativat për të krijuar **partneritet me odat/shoqatat vendore të biznesit dhe ofruesit e shërbimeve këshillimore të biznesit** për të promovuar dhe tërhequr investime në Kosovë.
 - Inicativat që synojnë mobilizimin e investimit nga **diaspora** në Kosovë.
 - Përpjekjet për të lehtësuar mundësitë e investimit nëpërmjet **partneriteteve publiko-private dhe ndërmarrjeve të përbashkëta**.
- Gatishmëria për investim:
 - Programet për të përmirësuar **gatishmërinë për investim** dhe atraktivitetin e bizneseve lokale, duke përfshirë mundësitë ekzistuese dhe ato me potencial për zhvillim.
- Avokimi i politikave:
 - Inicativat për të identifikuar, prioritetizuar dhe lehtësuar **pengesat për tërheqjen e investimeve**, dhe për të avokuar tek qeveria dhe palët e tjera të interesit për reformat përkatëse.
- Barazia gjinore dhe përfshirja sociale:
 - Iniciativa që promovojnë mundësi gjithëpërfshirëse të investimit në bizneset **në pronësi të grave dhe në pronësi të rinjve**, si dhe ndërmarrjet në pronësi të anëtarëve të komuniteteve të tjera të cënueshme.

Objektivi 2 – Rritja e financave të diversifikuara

Prioritetet kryesore të financimit përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Instrumentet alternative financiare:
 - Partneritetet me institucionet financiare për programe për zhvillimin e **instrumenteve të reja të diversifikuara financiare**, duke përfshirë **financimin e kapitalit qarkullues**.
 - Përpjekjet për vënë në funksion instrumentet e reja të kapitalit dhe borxhit dhe zhvillimin **tregjeve të kapitalit** në Kosovë.
 - Inicativat në teknologjinë financiare (fintech).

- Inicativat për mbledhjen e fondeve (crowdfunding).
- Qasja në shërbimet financiare:
 - **Programet e certifikimit** për konsulentët financiarë dhe profesionistët e tregjeve të kapitalit.
 - Inicativat për të zgjeruar qasjen e investitorëve dhe huadhënësve në **informacion për kreditimin e NVM-ve**, siç janë shërbimet e vlerësimit dhe vlerësimi kreditor i bizneseve.
 - Inicativat për **shërbime këshilluese për biznese** për të lehtësuar lidhjet ndërmjet bizneseve dhe institucioneve financiare dhe për të ndihmuar sipërmarrësit të aplikojnë për financim.
 - Përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin për qasjen e bizneseve në nevojat dhe kufizimet financiare, dhe për të **avokuar** për politikat përkatëse dhe reformat rregullatore.
- Fondet e investimeve:
 - Inicativat për zhvillimin e **fondeve të reja të investimeve** që mund të kanalizojnë financim për bizneset kosovare.
 - Inicativat për të zhvilluar dhe rritur **fondet e kapitalit të sipërmarrjes korporative** (corporate venture capital).
- Barazia gjinore dhe përfshirja sociale:
 - Inicativat për zhvillimin dhe prezantimin e produkteve dhe shërbimeve financiare inovative që synojnë mundësitë e biznesit për **gratë, të rinjtë dhe grupet e cenueshme**.
 - Programet që mbështesin integrimin e parimeve të **Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale** (BGPS) në institucionet financiare.
 - **Programet për ngritjen e kapaciteteve** në edukimin financiar, menaxhimin financiar të biznesit dhe bankat dhe tregjet e kapitalit për të avancuar pjesëmarrjen e grave në biznes dhe financa.

8. Fusha Tjera të Financimit

Siç u përmend, Aktiviteti do të jetë *gjithashtu* i hapur për shqyrtimin dhe vlerësimin e *propozimeve të tjera që bien jashtë fushave kryesore prioritare* të listuara më sipër. Aktiviteti do të ofrojë mundësi për aplikantët e mundshëm, partnerët dhe palët e tjera të interesit për të paraqitur ide të financueshme që janë inovative dhe me ndikim, dhe në përputhje me objektivat e përgjithshme të Aktivitetit.

9. Madhësia e Granteve dhe Periudha e Zbatimit

Në varësi të fondeve në dispozicion, shumat e dhëna në kuadër të kësaj mundësie financimi pritet të jenë:

- EUR 30,000 deri në EUR 230,000 (ose ekuivalent me vlerën USD 250,000).
- Shumat që janë nën vlerën EUR 30,000 mund të merren në konsideratë në rrethana të veçanta dhe të arsyetuara mirë.

Periodha e realizimit të aktiviteteve të financuara është maksimumi **2 vite**.

10. Pranueshmëria dhe Përshtatshmëria e Aplikantëve

Të gjitha grantet e dhëna në kuadër të Aktivitetit do t'i nënshtrohen kërkesave të përshtatshmërisë të përcaktuara më poshtë. Organizatat që kualifikohen duhet të jenë:

- Subjekte, institucione ose organizata të regjistruara ligjërish me bazë në Kosovë ose në SHBA. Organizatat e vendeve të treta mund të konsiderohen në baza individuale.
- Shoqëritë tregtare dhe/ose fitimprurëse, duke përfshirë bizneset (përfshirë institucionet financiare) dhe shërbimet e konsulencës, që kuptojnë se asnjë fitim ose tarifë nuk do të lejohet sipas marrëveshjes për grant.
- Organizatat jofitimprurëse/joqeveritare, odat dhe shoqatat e biznesit dhe të tjera sipas rastit.

Organizatat që kualifikohen duhet gjithashtu të:

- Demonstrojnë aftësi për të kontribuar në objektivat e Aktivitetit dhe për të ekzekutuar shumën e grantit në përputhje me parimet dhe praktikën e USAID dhe DT Global.
- Të shfaqin një menaxhim të shëndoshë financiar, administrativ dhe teknik në formën e një sistemi kontrollësh që mbron asetet dhe mbron nga mashtrimi dhe shpërdorimi.
- Kenë dëshmi të performancës së kënaqshme dhe dëshmi të integritetit dhe etikës së biznesit.
- Jenë në gjendje të vërtetojnë dhe të nënshkruajnë të gjitha certifikatat e detyrueshme (të listuara në **Shtojcën A**).

Organizatat që nuk kualifikohen përfshijnë:

- Individët.
- Partitë apo institucionet politike.
- Subjektet qeveritare.
- Organizatat që mbrojnë, promovojnë ose përkrahin politika antidemokratike ose aktivitete të paligjshme.
- Organizatat që synojnë të përdorin fondet për objektiva fetare.
- Subjektet që kanë keqpërdorur fondet e USAID-it në të kaluarën.
- Subjektet që janë në listën e palëve të përjashtuara nga programet federale të prokurimit dhe jo-prokurimit ose nga Komiteti i Sanksioneve të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara ose që kanë pronarë ose menaxherë që janë të përjashtuar.

Para dhënies së një granti sipas kësaj mundësie të financimit (DVP), aplikantëve të suksesshëm do t'u kërkohej të nënshkruajnë një Vërtetim në Lidhje me Financimin e Terrorizmit që vërteton se organizata e aplikantit nuk ofron dhe nuk ka ofruar asnjëherë ndihmë për terroristët për aktivitete terroriste. Aplikantëve të suksesshëm do t'u kërkohej të nënshkruajnë vërtetime të tjera të zbatueshme për grantin. Certifikatat/vërtetimet janë bashkangjitur si **Shtojca A** të kësaj DVP-je.

Para dhënies së një granti sipas kësaj DVP-je, aplikantët e suksesshëm do t'i nënshtrohen gjithashtu *përcaktimit të përgjegjësive para dhënies së grantit*, e cila do të zhvillohet nga Aktiviteti. Në marrjen e këtij përcaktimi, Aktiviteti do të përcaktojë nëse aplikanti posedon kapacitetin organizativ, kapacitetin financiar, kontrollet e brendshme, sistemet e prokurimit (nëse kërkohej) dhe dëshmitë

e performancës së kaluar në mënyrë që të zbatohet me sukses aktivitetet e grantit. Vetëm organizatat që janë përcaktuar të jenë përgjegjëse do të kenë të drejtë për grant.

Aktivitetet që kanë ndikim të dëmshëm në mjedis që nuk mund të zbuten nuk do të merren parasysh.

11. Kontributi i Përfituesit të Grantit

Aplikantët *inkurajohen fuqimisht* të ndajnë kostot e realizimit të aktiviteteve të propozuara.

Kontributi kundrejt kostos mund të financohet nga burimet e marrësit ose nga një kontribut i miratuar nga një palë e tretë. Të gjitha kontributet duhet të identifikohen qartë dhe të gjitha kostot e caktuara duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me kushtet mbizotëruese të tregut të hapur. Kontributet e palëve të treta janë të pranueshme dhe mund të konsiderohen pjesë e kontributit të marrësit pjesërisht ose tërësisht. Natyra dhe shuma e këtij kontributi do të përcaktohen qartë në Aplikacionin për Grant dhe në Marrëveshjen e Grantit.

12. Kërkesa për Identifikuesin Unik të Subjektit (UEI) dhe Sistemin e Menaxhimit të Granteve (SAM)¹

Njoftimi për mundësinë e financimit kërkon që çdo aplikant që aplikon dhe nuk përjashtohet sipas 2CFR § 25.110 (b) ose (c) të:

- (i) Regjistrohet në SAM para se të dorëzojë kërkesën e tij.
- (ii) Sigurojë identifikuesin e tij unik të subjektit në çdo kërkesë që i dorëzon agjencisë që jep grante.
- (iii) Mbjajë një regjistrim aktiv në SAM me informacion aktual gjatë gjithë kohës gjatë së cilës ka një grant federal aktiv ose një kërkesë ose plan në shqyrtim nga një agjenci federale që jep grante.

Të gjitha organizatat që aplikojnë për grante duhet t'i marrin këto regjistrime. Të gjitha janë pa pagesë.

13. Procesi i Aplikimit

Kjo mundësi financimi do të ketë një proces prej disa fazash të aplikimit dhe vlerësimit. Gjatë çdo faze të aplikimit, duke përfshirë fazën e para-aplikimit, Aktiviteti mund të përdorë *bashkëkrijimin* me aplikantët, i cili përfshin punën së bashku me aplikantët e mundshëm dhe aplikuesit e tjerë, me qëllim të sigurimit që propozimet e tyre të kenë ndikim më të madh dhe të jenë më shumë në harmoni me objektivat e Aktivitetit. *Fushëveprimi i plotë i asaj që do të përfshijë bashkë-krijimi me aplikantët është përshkruar në Seksionin 15 më poshtë.*

¹ UEI – Identifikuesi Unik i Subjektit është identifikues prej 12 karaktereve alfa-numerike që i caktohet një subjekti nga SAM.gov.

Faza 1: Dorëzimi i Shprehjes së Interesit (Koncept Notës)

Gjatë fazës së parë, nga aplikuesit kërkohet që ta dorëzojnë një Shprehje të Interesit (SHI), ku përshkruhet natyra e problemit që synojnë të trajtojnë, rëndësia e aktiviteteve të propozuara karshi qëllimeve të Aktivitetit, përshkrimi i aktiviteteve dhe detyrave kryesore të propozuara, rezultatet e pritura (duke përshkruar mënyrën se si rezultatet kontribuojnë në treguesit e rezultateve të projektit), plani i menaxhimit, përvoja e mëparshme relevante e aplikuesit dhe një buxhet fillestar i propozuar. SHI duhet të shpjegojë qartë dhe në mënyrë koncize qëllimin, rëndësinë, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme të aktivitetit të grantit të propozuar në mbështetje të objektivave të Aktivitetit të përcaktuara në këtë thirrje. Të gjitha SHI-të duhet të dorëzohen në formatin e SHI-së të përfshirë në **Shtojcën B** të kësaj thirrjeje dhe nuk duhet të kalojnë 5 faqe.

SHI-të mund t'i dorëzohen Aktivitetit në çdo kohë para datës dhe kohës së mbylljes siç specifikohet në këtë thirrje. **Megjithatë, aplikimet e hershme inkurajohen fuqimisht.** Aplikantët duhet të dorëzojnë SHI-të me shkrim te Menaxheri i Granteve dhe Nënkontratave të Aktivitetit në mënyrë elektronike, përmes e-mailit në adresën grants.ipaf@dt-global.com. Data e fundit për dorëzimin e SHI-ve është **30 shtator 2024**, dhe koha e fundit për dorëzimin e SHI-ve është ora 15:00 sipas kohës lokale të Kosovës (Koha e Evropës Qendrore) në atë datë. SHI-të e dorëzuara pas kësaj date dhe ore nuk do të merren parasysh në këtë DVP.

Aktiviteti do të caktojë Komisionin Vlerësues të Granteve (KVG) që do t'i vlerësojë SHI-të e dorëzuara si përgjigje ndaj kësaj mundësie për financim në *baza të vazhdueshme*. SHI-të do të vlerësohen bazuar në kriteret e specifikuar më poshtë (shih Seksionin 14). Nëse SHI-ja e një aplikanti pranohet nga Komisioni Vlerësues i Granteve, aplikanti do të ftohet të dorëzojë një Formular të Plotë të Aplikimit për Grant siç detajohet më poshtë.

Faza 2: Dorëzimi i Aplikimit të Plotë për Grant

Pas vlerësimit të SHI-ve, Aktiviteti do të ftojë organizatat që kanë dorëzuar SHI të suksesshme që të dorëzojnë një Aplikimin e Plotë për Grant (APG) bazuar në konceptin dhe qasjen teknike të propozuar në SHI. Të gjitha kërkesat duhet të dorëzohen në formatin e formularit të Aplikimit të Plotë për Grant të përfshirë në **Shtojcën C** të kësaj thirrjeje. Formatin e APG-së kërkon që aplikantët të japin detaje mbi aktivitetin e propozuar të grantit, objektivat e tij, ndikimin e synuar sistematik dhe rezultatet e pritshme, duke përfshirë përshkrimin e përfituesve të synuar dhe palëve të interesit, strukturën e propozuar të personelit dhe buxhetin e detajuar të grantit. APG-ja nuk duhet të kalojë 15 faqe. Kërkesat mbi 15 faqe mund të mos shqyrtohen nga Aktiviteti.

14. Vlerësimi dhe Përzgjedhja

Aktiviteti do të caktojë Komisionin Vlerësues të Granteve i cili do të shqyrtojë në mënyrë të vazhdueshme Shprehjet e Interesit ashtu edhe APG-të e paraqitura në përgjigje të kësaj mundësie për financim.

KVG do të vlerësojë SHI-të ashtu edhe APG-të bazuar në kriteret e mëposhtme të vlerësimit:

Kriteret e vlerësimit	Pyetjet kryesore gjatë vlerësimit	P
1. <u>Përshtatshmëria me Objektivat Kryesore të Aktivitetit</u>	<p>A janë aktiviteti i propozuar i grantit, qëllimet dhe objektivat në përputhje me objektivat e Aktivitetit (d.m.th. tërheqja e investimeve dhe rritja e diversifikimit të produkteve financiare në dispozicion).</p> <p>Në çfarë mase aktiviteti i propozuar i grantit, qëllimet dhe objektivat e aplikacionit kontribuojnë në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Aktivitetit të përcaktuara në këtë thirrje?</p>	10
2. <u>Shkalla në të Cilën Aplikimi Adreson Kufizimet Kryesore</u>	<p>Deri në çfarë mase aktiviteti i propozuar i grantit adreson kufizimet kryesore të identifikuara në Analizën e Kufizimeve të Financave dhe Investimeve?</p> <p>A dëshmon aplikanti se e ka të qartë se cilat probleme/çështje kryesore do të adresojë aktiviteti i propozuar?</p>	10
3. <u>Shkalla në të Cilën Aplikimi Sjell Ndikim Sistemik dhe të Qëndrueshëm</u>	<p>A është e besueshme që partneri do të vazhdojë me këtë veprim në të ardhmen pa mbështetjen e Aktivitetit?</p> <p>A ka gjasa që nga aktivitetet e propozuara të përfitojnë një numër i madh akterësh të tjerë, apo shumica e përfitimit do t'i mbetet partnerit?</p>	10
4. <u>Ndikimi dhe Rezultatet</u>	<p>Cilat janë rezultatet e synuara të aktivitetit të propozuar të grantit?</p> <p>A kontribuon aktiviteti i propozuar në më shumë se një tregues të rezultateve siç përshkruhet në seksionin 6 dhe cili është ndikimi i pritur?</p> <p>Deri në çfarë mase aktiviteti i propozuar çon në mobilizimin e burimeve, investimeve apo financimeve shtesë?</p>	30
5. <u>Cilësia e Aplikacionit të Dorëzuar</u>	<p>A është synimi i përgjithshëm i aktivitetit të propozuar të grantit, i formuluar qartë dhe i arritshëm?</p> <p>A propozon aplikuesi aktivitete specifike që janë logjike, realiste dhe relevante për synimin e aktivitetit të grantit?</p> <p>A është e qartë se si do të kontribuojë përmbushja e synimit të përgjithshëm të aktivitetit të grantit dhe objektivave specifike në zgjidhjen e çështjeve/sfidave kyçe?</p> <p>A është ideja(të) e propozuara inovative dhe e/të reja në treg?</p> <p>A ka aktiviteti i propozuar pas vetes një model biznesi të qëndrueshëm/solid?</p>	10
6. <u>Kapaciteti i</u>	A ka organizata përvojë përkatëse në të kaluarën në	15

<u>Aplikantit dhe Përvoja e Kaluar</u>	implementimin e aktiviteteve të ngjashme?	
	A ka aplikanti burime të mjaftueshme njerëzore, teknike, menaxheriale dhe burime të tjera në dispozicion për të zbatuar me sukses aktivitetin e propozuar?	
	A vlerësohet mirë aplikuesi nga ana e akterëve brenda tregut për sa i përket gatishmërisë së tij për të kryer aktivitetin e propozuar?	
<u>7. Efektiviteti i Kostos dhe Kontributi i Përfituesit të Grantit</u>	Çfarë niveli të kontributit në kosto do të ofrojë organizata/aplikanti për të maksimizuar koston e grantit?	15
	A është buxheti i propozuar realist, i menduar mirë dhe në përputhje me aktivitetet e propozuara?	
	A janë kostot e propozuara të arsyeshme, të lejueshme dhe të alokuara për grantin?	
Totali		100

Nëse KVG pranon SHI-në bazuar në kriteret e mësipërme, Aktiviteti do të njoftojë aplikantin me shkrim dhe do ta ftojë organizatën të paraqesë Aplikimin e Plotë për Grant. Afati i fundit për APG do t'i komunikohet aplikantit të suksesshëm pas njoftimit se SHI është pranuar. KVG do të vlerësojë APG-në bazuar në kriteret e listuara më sipër.

Aktiviteti rezervon të drejtën për të financuar ndonjë ose asnjë nga kërkesat e paraqitura. Lëshimi i kësaj DVP-je nuk përbën një zotim për dhënie të grantit nga ana e Aktivitetit dhe as nuk e detyron Aktivitetin të paguajë për kostot e bëra në përgatitjen dhe dorëzimin e SHI-së ose formularit të plotë të aplikimit për grant. Më tej, Aktiviteti rezervon të drejtën të refuzojë cilëndo ose të gjitha kërkesat e pranuar nëse një veprim i tillë konsiderohet të jetë në interesin më të mirë të Qeverisë së SHBA-ve. **Aplikanti e bartë rrezikun e dorëzimit të aplikacionit; nëse rrethanat e pamundësojnë dhënien e grantit, të gjitha shpenzimet e përgatitjes dhe dorëzimit janë në barrë të aplikuesit.**

15. Bashkë-Krijimi me Aplikuesit

Siç u përmend, sipas kësaj mundësie të financimit (DVP), Aktiviteti do të përdorë një sistem konkurrimi në disa faza. Objektivat e konkurrimit në disa faza janë si në vijim:

- Shqyrtimi paraprak i qasjeve, metodologjive dhe objektivave teknike të aktiviteteve të propozuara të grantit për të përcaktuar nëse ato janë në përputhje me objektivat e Aktivitetit dhe do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të projektit.
- Përcaktimi se aplikanti zotëron aftësitë teknike dhe përvojën e nevojshme për të kryer aktivitetet dhe për të kontribuar drejt objektivave të Aktivitetit.
- Arritja e efikasitetit në mënyrë që përfituesit e pakualifikuar të grantit ose përfituesit e granteve që propozojnë koncepte të grantit ose qasje që nuk janë në përputhje me objektivat e projektit, të mos shpenzojnë burimet për përgatitjen e formularit të plotë të aplikimit për grant.

Në përputhje me procesin e aplikimit të përshkruar në Seksionin 13 të këtij dokumenti, Aktiviteti do të bashkëkrijojë në mënyrë aktive dhe nga afër aktivitete dhe propozime me aplikuesit e

mundshëm. Kjo mund të përfshijë bashkëkrijimin me një ose me shumë aplikues dhe mund të ndodhë në faza të ndryshme të procesit të aplikimit siç përshkruhet në Seksionin 13 të këtij dokumenti. Bashkëkrijimi është një praktikë e lejuar brenda projekteve të USAID-it me qëllim të përmirësimit të cilësisë së aktiviteteve të propozuara, bazuar në një bashkëpunim proaktiv ndërmjet financuesit dhe zbatuesve të mundshëm.

Për më tepër, bashkëkrijimi ofron hapësirën e nevojshme ndërmjet Aktivitetit dhe aplikantëve të mundshëm për të përfshirë kontributin e sektorit privat dhe të akterëve të tjerë të rëndësishëm në procesin e identifikimit të problemeve dhe propozimit të zgjidhjeve. Me anë të bashkëkrijimit, Aktiviteti mund të vërtetojë dhe të zbërthejë më tej kufizimet që pengojnë rritjen e investimeve dhe financimit përmes përpjekjeve të përbashkëta bashkëpunuese me partnerët e interesuar. Bashkëkrijimi mund të çojë gjithashtu në një kuptim të përmirësuar të interesave dhe objektivave të partnerit, duke përmirësuar kështu angazhimin përmbajtësor të tij.

Për të maksimizuar kontributin dhe bashkëpunimin thelbësor në hartimin e propozimeve të suksesshme, procesi i mësipërm i bashkëkrijimit do të karakterizohet nga një komunikim intensiv dhe i gjerë ndërmjet Aktivitetit, sektorit privat, partnerëve të mundshëm zbatues dhe partnerëve të tjerë të mundshëm, si qeveria dhe subjektet joqeveritare. Përmes bashkëkrijimit, Aktiviteti mund të ketë diskutime të detajuara me partnerët përkatës gjatë gjithë procesit, nga angazhimi i hershëm me akterët kryesorë lidhur me qasjet dhe zgjidhjet e mundshme para dorëzimit të një koncepti, deri te përsosja e mëtejshme dhe zhvillimi i vazhdueshëm i koncepteve dhe aplikacioneve të plota të dorëzuara, e deri te hartimi përfundimtar dhe negociimi i marrëveshjeve ose granteve.

Siç përshkruhet në Seksionin 13 të këtij dokumenti, procesi i konkurrimit i Aktivitetit përfshin dorëzimin e Shprehjeve të Interesit apo Koncept Notave, të cilat nëse miratohen, pasohen me dorëzimin e aplikacionit të plotë për grant. Bashkëkrijimi nga Aktiviteti do t'i mundësojë projektit të angazhohet me aplikuesit e mundshëm në çdo fazë të procesit të aplikimit, duke përfshirë gjatë periudhës së para-aplikimit në formën e diskutimeve të përbashkëta (*brainstorming*) me partnerët rreth ideve të mundshme të ndërhyrjes që mund të financohen nga kjo thirrje për financim (DVP).

Për shembull, edhe para se partnerët të dorëzojnë Shprehjen e Interesit, Aktiviteti mund të eksplorojë me partnerë të mundshëm për të kuptuar qëllimet dhe interesat e tyre, për të identifikuar sfidat dhe zgjidhjet, dhe për të eksploruar ekspertizën e tyre përkatëse duke përfshirë burimet dhe kapacitetet. Këto diskutime mund të ndihmojnë Aktivitetin dhe partnerët të fillojnë formulimin e ndërhyrjeve, aktiviteteve dhe qasjeve të mundshme. Angazhimi para fazës së aplikimit me partnerët mund të nevojitet për të kuptuar më mirë sfidat specifike me të cilat përballen një çështje dhe akterët e tij, dhe për të eksploruar rrugët për krijimin e ndryshimeve sistemike.

Pasi të dorëzohet Shprehja e Interesit (Koncept Nota), Aktiviteti mund të kontaktojë me aplikantët për sqarime ose informacione shtesë. Projekti gjithashtu mund të planifikojë takime pune për të shqyrtuar qasjen e propozuar dhe për të ndryshuar propozimin për të përmirësuar ndikimin e tij kundrejt objektivave të projektit për të arritur ndikimin e dëshirueshëm sistematik. Gjatë kësaj faze, Aktiviteti dhe partnerët mund të angazhohen në diskutime shumë më të hollësishme dhe të plota për të përcaktuar dhe rafinuar së bashku aktivitete specifike dhe për të specifikuar rolet e partnerëve.

Përveç kësaj, pasi të dorëzohet Formulari i Plotë për Aplikim Granti, Aktiviteti mund të vazhdojë angazhimin me aplikantët për të ndërtuar, zhvilluar dhe përmirësuar më tej qasjen e përgjithshme dhe aktivitetet e propozuara. Gjatë kësaj faze, nuk do të ishte e pazakontë që, përmes procesit

shumë bashkëpunues të bashkëkrijimi, idetë dhe aktivitetet e paraqitura fillimisht në fazën e konceptit të evoluojnë ndjeshëm, pasi partnerët përsosin qasjet e tyre në mënyrë që të identifikojnë mënyrën më të mirë për të arritur rezultate më të mëdha të mundshme. Për më tepër, në fazën e Shprehjes së Interesit/Koncept Notës apo në fazën e FPAG, partnerët mund të përcaktojnë që subjekte të tjera duhet të përfshihen në aktivitetet e propozuara. Çelësi është që theksi të jetë në arritjen e të kuptuarit të përbashkët të sfidave, problemeve dhe mundësive që duhen adresuar dhe në përcaktimin e mënyrave më të mira për ta bërë këtë.


Gjatë bashkëkrijimit, Aktiviteti do të sigurojë gjithashtu se ekzistojnë masa mbrojtëse rigorozë për të shmangur sfidat e konfliktit të interesit. Përkatësisht, Aktiviteti do të sigurojë që për asnjë subjekt nuk do të krijohen avantazhe konkurruese të padrejta. Aktiviteti do të përpiqet në masën maksimale të mundshme për të siguruar që të gjithë partnerët e mundshëm zbatues të kenë qasje në informacion të barabartë. Nëse ndonjë informacion jopublik zbulohet gjatë procesit të bashkëkrijimit, kjo do të bëhet me mirëkuptimin e akterëve të përfshirë që i njëjti informacion duhet të vihet në dispozicion të të gjitha palëve të interesit që dëshirojnë të aplikojnë. Aktiviteti do të sigurojë gjithashtu që të gjithë aplikuesve t'u ofrohen shanse të barabarta për aplikimin, pavarësisht nga pjesëmarrja e tyre në diskutimet e bashkëkrijimit me projektin.

16. Zbutja e Shtrembërimit të Tregut

Aktiviteti do të sigurojë procedura të qarta, transparente dhe konkurruese për grantet e financuara nga projekti me konsiderata kryesore që përfshijnë: rezultatet e pritshme, deformimin e tregut dhe pjesën e kostos. Propozimet për grante do të vlerësohen dhe miratohen me qëllim të shmangies së deformimit të tregut ose favorizimit të një subjekti ndaj një tjetri.

Qëllimi i programit të granteve të Aktivitetit nuk është që të përdoret si financim i drejtpërdrejtë ose ofrim i subvencioneve, por për të avancuar konkurrencën e përgjithshme brenda fushave të fokusit të Aktivitetit. Fondi nuk do të përdoret për të ofruar subvencione të padrejta që konkurrojnë me institucionet financiare ekzistuese. Fondi do të strukturohet dhe menaxhohet për të siguruar që ai të mos deformat tregun vendas. Kriteret kryesore për rishikimin dhe miratimin e granteve do të jenë përfitimet e pritshme sasiore dhe cilësore të aktivitetit të propozuar, duke përfshirë vlerësimet e arsyeshme të rritjes së investimeve dhe financave që do të gjenerohen në krahasim me koston totale të aktivitetit dhe pjesën e propozuar të kostos. Të gjitha grantet, dhe në veçanti ato për firmat fitimprurëse, do të përfshijnë dispozita të përshtatshme për të siguruar që të ardhurat e programit të përdoren për të çuar më tej objektivat e pranueshme të programit.

17. Aplikimi, Vlerësimi dhe Realizimi i Grantit



18. Administrimi i dhënies së grantit

Në bazë të 2 CFR 200 Nën pjesa E dhe 2 CFR 700.13, është politikë e USAID-it të mos paguaj fitim me instrumentet për asistencë. Megjithatë, të gjitha shpenzimet e arsyeshme, të ndara dhe të lejueshme, direkte dhe indirekte, të cilat lidhen me aktivitetin e grantit dhe janë në përputhje me standardet e aplikantëve të kostos (2 CFR 200 Nën pjesa E për organizatat jofitimprurëse dhe institucionet arsimore, dhe Rregulloren Federale për Blerje (FAR) Pjesa 31.2 për organizatat fitimprurëse), mund të paguhet sipas grantit.

Çdo grant i dhënë do t'i nënshtrohet termeve dhe kushteve të Kontratës Kryesore për Aktivitetin.

I. Shtojcat

- A. Certifikatat, Garancitë dhe Deklaratat e tjera të Ofertuesve.
- B. Formati i Shprehjes së Interesit.
- C. Formati i Formularit të Aplikimit për Grant.